



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 122 Vendimi

Tiranë, më 26.03.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Anisa Duka, sot më datë 26.03.2019, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

Subjektit të rivlerësimit: Znj. Drita Velia, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Baza ligjore: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES:

Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 10.09.2018, i është njoftuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendimi nr. 15, datë 10.02.2017, “Për Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për pension”, të gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, znj. Drita Velia, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës së saj për pension, më datë 29.11.2017.

1. Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi më datë 08.10.2016.
2. Më datë 25 .10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri në 19 janar 2017. Më datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare, më datë 19.01.2017. Si rezultat afati 30 ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31 janar 2017.
3. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për znj. Drita Velia, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ka filluar menjëherë me:
 - a. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b. Plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c. Plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41;
4. Me vendimin nr.16 datë 26.02.2019, mbledhja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka vendosur ngritjen e trupit gjykues që do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit, për një periudhë 1 vjeçare.
5. Trupi gjykues i shortuar për këtë qëllim është i përbërë nga komisionerët:
 - Pamela Qirko
 - Lulzim Hamitaj
 - Etleda Çiftja

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

6. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”
7. Pika 3 e nenit 179/b i Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.
8. Trupi gjykues konstaton se znj. Drita Velia, ka qenë me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.
9. Me vendimin nr. 15, datë 10.02.2017, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të mbushjes së moshës për pension, më datë 26.09.2017, të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, znj. Drita Velia.
10. Neni 160, paragrafi 1, pika “ë”, e ligjit nr. 96/2016, përcakton se: *“Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj, duke vërtetuar ndërprerjen e emërimit, në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit;*
11. Trupi gjykues çmon se objekti për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit apo qëllimi i këtij procesi, është bërë i pamundur, referuar nenit 95, *“Pamundësia në objekt apo qëllim”*, të Kodit Procedurës Administrative, i cili specifikon se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative panjë vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.
12. Ligji nr. 84/2016, në pikën 6 të nenit 4, parashikon se, kur është rasti institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 4 pika 6 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 64, pika 1, germa “c”, e ligjit nr. 96/2016.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për **znj. Drita Velia**, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Ky vendim u njoftohet, znj. Drita Velia, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.
3. Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, më datë 26.03.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Lulzim HAMITAJ
Relator

Anisa Duka
Sekretare gjyqësore